



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/102;
Datë: 26.08.2016 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nri faq	Data
2-02-6962	1	30.08.2016

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 3 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.07.2016 nxjerrë:

V E N D I M

për themelimin e Komisionit të Ankesave

I. Me këtë vendim themelohet Komisioni i Ankesave/në tekstin e mëtejme Komisioni/ për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Junikut në shfrytëzim.

II. Komisioni në mbledhjen e tij të parë zgjedh kryetarin e Komisionit.

III. Mandati i anëtarëve të Komisionit nga pika I. e këtij vendimi është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

IV. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë:

Shqyrtimi i ankesave që do të paraqiten nga palët e pa kënaqura ofertuese pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për periudhën afatshkurtër apo afatgjatë sipas procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Faik Tofaj

